



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Detyruar Punëpunë/Prodator Receveo/Delivry	29 - 03 2023	3 viti god veçit	
Organ /Njësia Organ /Jedinstva Org /Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHMITHCK	3123/2023		1/2



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.378/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në lidhje me ankesën me numër A.nr.378/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në Komunën e Vitisë, kundër organit të punësimit/Komuna e Ferizajit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.03.2023, mori këtë:

### V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.378/2023 të datës 21.02.2023, e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja me datën 21.02.2023, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1948/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.01-45-2023 të datës 20.02.2023, i nxjerrë nga Komisioni i pranimit të Komunës së Ferizajt, pas detyrimit për vendosje nga ana e Komisionit të Pranimit të Komunës së Ferizajt sipas Vendimit me numër A.nr.908/2022 të datës 09.12.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për rastin e ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me vendosjen e ankesës së ankueses në mënyrë meritore dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të saj, konstaton se ka marrë për bazë Vendimin me numër A.nr.986/2022 të datës 23.12.2022 i lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas të cilit janë evidentuar shkeljet në procesin e rekrutimit i shpallur me datën 18.07.2022 me numër të Referencës RN00009496 lidhur me emrin e grupit Specialist të Administrimit të Përgjithshëm për tri (3) pozitat: "Asistent administrativ",





“Zyrtar për evidentimin e Pronës së Paluajtshme” dhe “Zyrtar për gjendje civile 4” dhe të njëjtin e ka anuluar në tërësi.

Andaj nga theksimet si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se meqë pretendimet e ankueses lidhen me procesin e rivlerësimit për pozitën në fjalë e cila procedurë në lidhje me këtë konkurs është anuluar në tërësi me Vendimin me numër A.nr.986/2022 të datës 23.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë në këtë kuptim të njëjtat pretendime janë të pamundura të shqyrtohen ngase tanimë nuk kanë objekt shqyrtimi. Kështu që në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”, Kolegji i Këshillit, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të inicuar sipas ankesës me numër A.nr.378/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.378/2023, datë 29.03.2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.